



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË

PROJEKT VENDIM

Nr. Datë

“PËR TRANSFERIMIN E ADMINISTRIMIT DHE VEPRIMTARISË SË QENDRËS KULTURORE “FAN NOLI” DHE KLUBIT SPORTIV “GRAMOZI” PRANË SHOQËRISË TREGTARE “GREEN KOLONJA” SH.A., SI DHE PËR MBYLLJEN E NIPT-EVE PËRKATËSE

Në zbatim dhe mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji nr.9936 datë 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë I ndryshuar, të Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.31, datë 20.02.2026 “Për një ndryshim në vendimin nr.133 datë 27.11.2025 për miratimin e themelimit të shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a.”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë transferimin e administrimit dhe veprimtarisë të Qendrës Kulturore “Fan Noli” dhe Klubit Sportiv “Gramozi” pranë shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a.
2. Shoqëria tregtare “Green Kolonja” sh.a. do të marrë në administrim dhe përdorim të gjitha aktivitetet sportive, kulturore dhe artistike që ushtroheshin nga Klubi Sportiv “Gramozi” dhe Qendra Kulturore “Fan Noli”.
3. Të gjitha asetet, inventari, pajisjet, materialet dhe ambientet në përdorim të Klubit Sportiv “Gramozi” dhe Qendrës Kulturore “Fan Noli” t’i transferohen për administrim shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a., sipas procesverbaleve dhe inventarëve përkatës.
4. Të drejtat dhe detyrimet administrative, kontraktore dhe financiare që lidhen me aktivitetin e Klubit Sportiv “Gramozi” dhe Qendrës Kulturore “Fan Noli” t’i kalojnë shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a., sipas legjislacionit në fuqi.
5. Personeli i angazhuar në këto struktura të trajtohet sipas legjislacionit në fuqi dhe nevojave organizative të shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a.
6. Të miratohet mbyllja/çregjistrimi i NIPT-eve ekzistuese të: Klubit Sportiv “Gramozi” dhe Qendrës Kulturore “Fan Noli” sipas procedurave ligjore pranë institucioneve përgjegjëse.

7. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Kolonjë, Administratori i shoqërisë “Green Kolonja” sh.a., Drejtoria e Financës dhe strukturat përgjegjëse për ndjekjen dhe realizimin e procedurave administrative, financiare, tatimore dhe ligjore për zbatimin e këtij vendimi.
8. Ngarkohet Drejtoria e Artit, Kulturës dhe Sportit për hartimin e dokumentacionit të nevojshëm të inventarizimit dhe dorëzimit të aseteve.
9. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga prefektura .

**KRYETARI I BASHKISË
ERION ISAI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KOLONJË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr 3182 Prof

Errokë: 22.08.2026

RELACION PËR
PROJEKT-VENDIM
Nr. Datë /06/ 2026

“PËR TRANSFERIMIN E ADMINISTRIMIT DHE VEPRIMTARISË SË QENDRËS KULTURORE “FAN NOLI” DHE KLUBIT SPORTIV “GRAMOZI” PRANË SHOQËRISË TREGTARE “GREEN KOLONJA” SH.A., SI DHE PËR MBYLLJEN E NIPT-EVE PËRKATËSE

TË NDERUAR!

Në kuadër të organizimit dhe administrimit më eficient të aktiviteteve sportive, kulturore dhe artistike në Bashkinë Kolonjë, si dhe mbështetur në krijimin e shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a., paraqitet nevoja për transferimin e administrimit dhe veprimtarisë së Klubit Sportiv “Gramozi” dhe Qendrës Kulturore “Fan Noli” pranë kësaj shoqërie tregtare.

Shoqëria “Green Kolonja” sh.a. është krijuar me qëllim administrimin dhe zhvillimin e aktiviteteve me karakter ekonomik, kulturor, sportiv dhe turistik, duke krijuar mundësi për menaxhim më fleksibël dhe eficient të shërbimeve dhe aktiviteteve publike.

Aktualisht, Klubi Sportiv “Gramozi” dhe Qendra Kulturore “Fan Noli” funksionojnë si njësi me NIPT më vete në varësi të Drejtorisë së Artit, Kulturës dhe Sportit. Për shmangien e mbivendosjeve administrative dhe për një administrim të unifikuar financiar e organizativ, propozohet kalimi i veprimtarisë së tyre pranë shoqërisë tregtare “Green Kolonja” sh.a., si dhe mbyllja e NIPT-eve ekzistuese.

Ky transferim synon rritjen e eficiencës administrative dhe financiare, unifikimin e menaxhimit të aktiviteteve sportive dhe kulturore, përmirësimin e mundësive për aplikime në projekte dhe sponsorizime, rritjen e kapaciteteve organizative dhe menaxhuese, administrimin më efektiv të aseteve publike.

Transferimi do të realizohet nëpërmjet procesverbaleve dhe inventarëve përkatës, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

PUNOI: Eni Duro

KONFIRMOI: Drejtori D.Ç.J.P.P O.LIFO